

Teoria mbi parandalimin e konflikteve. Çfarë mund të përfitojë Kosova nga kjo?

Rok Zupančič*

Përmbledhje

Në këtë punim bëhet fjalë për teorinë e konceptit mbi parandalimin e një konflikti. Nëse politikanët kosovarë duan që vërtet ta stabilizojnë shtetin e ri, atëherë duhet të gjejnë zgjidhje dhe t'i marrin në konsideratë rekomandimet e teorisë mbi parandalimin e një konflikti, dhe pastaj ta gjejnë mënyrën e tyre për t'i zgjidhur problemet nga fusha e politikës, shoqërisë, ekonomisë dhe kulturës. Me vonë, vendimmarrësit dhe zyrtarët e lartë duhet t'i hartojnë strategjitë e tyre të veçanta dhe politikatat mbi parandalimin e konflikteve, për t'u zvogëluar kështu mundësitë e një shkallëzimi të ri të dhunës. Ky punim paraqet disa arsye historike dhe bashkëkohore mbi origjinën e dhunës dhe lidhjen e tyre me parandalimin e konflikteve. Punimi, po ashtu, sqaron zhvillimin e konceptit të parandalimit të konflikteve bashkëkohore, duke filluar që nga nisma e KB-së në vitin 1960, e cila u avancua në mënyrë gjithëpërfshirëse në Bashkimin Evropian, dhe nga disa organizata të tjera ndërkombëtare. Dallimi në mes të parandalimit struktural dhe parandalimit operativ të konflikteve shpjegohet në fund të këtij punimi, duhet theksuar se, parandalimi struktural i konflikteve është i domosdoshëm për Kosovën, si shtet i ri, i cili u shfaq rishtas në fushën politike në Ballkanin Perëndimor.

Fjalët kyç: parandalimi i konflikteve, arsyet dhe motivet për luftëra, Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, parandalimi struktural dhe ai operativ i konflikteve, Kosova.

“Shtetet-kombe nuk duken të prirura për të shkuar në luftë me njëri-tjetrin, por grupet etnike luftojnë tërë kohën”

Daniel P. Moynihan

* Rok Zupančič është Asistent i Hulumtimeve dhe kandidat i doktoraturës në Fakultetin e Shkencave Shoqërore në Universitetin e Lubjanës, Slloveni.
Rok.Zupancic@fdv.uni-lj.si

“Ne mundohemi të studiojmë se si shkaktohen luftërat dhe si luftohen ato, në vend se të mendojmë si t’i parandalojmë ato”.

Michael S. Lund

“Teoritë e gjëra gjithëpërfshirëse rreth konfliktit mund të jenë të mira për fjalime kryesore dhe sigurisht për pushtete mbretërore /.../ por ato asnjëherë nuk duken të kenë funksionuar aq mirë në praktikë.”

Gareth Evans

Hyrje

Një vit pas shpalljes së Pavarësisë, elita politike e Kosovës¹ duhet të shikojë mbrapa se çka është arritur gjatë kësaj periudhe kohore. Nëse të gjitha përpjekjet e elitës kosovare deri në shkurt 2008 ishin të përkushtuara në sigurimin e ndihmës ndërkombëtare për njohje të vendit të ri, atëherë një vit pas, udhëheqja duhet të përpiqet të krijojë përforsim të shtetit në fushën politike, ekonomike, sociale dhe etnike. Njëri ndër prioritetet kyç për Kosovën, i cili mund të krijojë stabilitet në shtetin e ri të Ballkanit Perëndimor, dhe i cili duhet të jetë synim i politikanëve, ekspertëve si dhe i qytetarëve të Kosovës, është parandalimi kompleks dhe i qëndrueshëm i konfliktit në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, sociale dhe asaj kulturore.

Qëllimi i këtij punimi nuk është vlerësimi i asaj se çka ka bërë udhëheqja kosovare që nga shpallja e pavarësisë lidhur me botën komplekse dhe “dredharake” të parandalimit të konflikteve, por të vë në pah aspektet praktike dhe ato teorike të parandalimit të konflikteve, të cilat elitat politike duhet gjithmonë t’i kenë në mendje kur marrin vendime politike në të ardhmen. Me fjalë të tjera, qëllimi i këtij punimi është që të ngritet vetëdija e politikanëve (vendimmarrësve), intelektualëve dhe anëtarëve të

¹ Unë këtu e përdor termin Kosovo (dhe jo Kosova) sepse punimi është shkruar në gjuhën angleze. Termi Kosovo përdoret edhe nga UNMIKU si dhe disa organizata ndërkombëtare si dhe në disa ueb faqe të Qeverisë së Kosovës në gjuhën angleze (p.sh. në portalin kryesor të institucioneve qeveritare të Kosovës, <http://www.ks-gov.net/>).

tjerë të interesuar të shoqërisë, që, parandalimi i suksesshëm i një konflikti,² bazuar në standarde demokratike, është njëri ndër elementet thelbësore të një entiteti politik të organizuar mirë, i cili angazhohet për demokraci, tranzicion të suksesshëm dhe mirëqenie të popullit të tij.³

Vetëm për të evituar përdorimin e termit, parandalim të konflikteve të armatosura vdekjeprurëse, është përdorur termi, *parandalim i konflikteve* në këtë punim, që nuk do të thotë se të gjitha konfliktet duhet të parandalohen ose evitohen – disa konflikte madje kanë qenë të dobishme.⁴ Prandaj, ajo që duhet të parandalohet janë konfliktet shkatërruese dhe ato të dhunshme, të cilat mund të evitohen nëse merren vendimet e duhura.

Ballkani Perëndimor ka qenë një dëshmi e heshtur e mos veprimit dhe mos parandalimit - Kosova nuk bënte përjashtim.⁵ Sidomos persekutimi i disa komuniteteve etnike ka mundur të evitohet sikur të ishin aplikuar me kohë strategjitë, politikat, mekanizmat, mjetet dhe veprimet e duhura nga komuniteti ndërkombëtar.

² Për më tepër mbi dështimin e intervenimit ndërkombëtar dhe mundësitë për të parandaluar konfliktin në Kosovë që nga viti 1980, e deri tek intervenimi ushtarak i NATO-së më 1999 shih në: Weller, Marc, *Peace Lost: The Failure of Conflict Prevention in Kosovo*, 2008, Hotei Publishing, Amsterdam.

³ Liderhipi politik është i vetëdijshëm, të paktën zyrtarisht, që duhet të zhvillojë një proces parandalimi afatgjatë. Në fjalimin e tij, gjatë takimit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës me 11 shkurt 2009 në Prishtinë, Kryeministri Hashim Thaqi ka pohuar se do t'i formojë dhe përforcojë institucionet e sigurisë, që të jenë të gatshme të parandalojnë konflikte dhe t'i bëjnë ballë çdo kërcënimi të sigurisë. (Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës: *Një Kosovë e sigurt do të thotë prosperitet për popullin e saj dhe stabilitet në rajon*. 11 Shkurt, 2009). <http://www.ks.gov.net/pm/Fillimi/tabid/36/EntryID/1672/Default.aspx>, vizituar me 14 Shkurt 2009.

⁴ "Konflikti është pjesë e jetës, i cili ofron mundësi të shumta për të përmirësuar pikëpamjet dhe mirëkuptimin mbi atë, ekziston një tendencë për ta vështruar konfliktin si një përvojë negative, gjë që u krijua në bazë të disa rrethanave jashtëzakonisht të vështira." (Universiteti i Wisconsin, Zyra për Zhvillim të Resurseve Njerëzore- *Mbi Konfliktin*. <http://www.ohrd.wisc.edu/onlinetraining/resolution/aboutwhatisit.htm#whatisconflict>, vizituar me 14 Shkurt 2009).

⁵ Për më tepër mbi dështimin e intervenimit ndërkombëtar dhe mundësitë për të parandaluar konfliktin në Kosovë që nga viti 1980 e deri tek intervenimi ushtarak i NATO-së më 1999, shih në: Weller, Marc, *Peace Lost: The Failure of Conflict Prevention in Kosovo*, 2008, Hotei Publishing, Amsterdam.

***“Agresioni është shndërruar në njerëz.”
A mund të parandalohet konflikti?***

“Kurrë më!”

*“Ne nuk kemi mundur të bëjmë asnjë gjë
për t'i parandaluar masakrat”.*

Këto janë dy shprehje të forta të cilat i dëgjojmë shpesh kur ndodhin edhe të tjera marrëzi dhe mizori të tilla, si mizoritë në Ruandë, Bosnjë ose Kosovë, që bien mbi supet e lodhura të komunitetit ndërkombëtar. Megjithatë, këto dy fjali duken të jenë të ndërthurura në paradoks logjik: nëse qëndrimi i parë vendimtar nënkupton angazhim të fortë për të shpenzuar atomin e fundit të energjisë për të parandaluar gjakderdhje, argumenti i dytë (i cili është gjithashtu i motivuar politikisht si ai i pari dhe mund të quhet një justifikim) nënkupton “Pontius Pilate’s hand-washing”. (Iarja në dorë e Pontius Pilatit).

“Larja në dorë” si e tillë nuk do të ishte aq rrezik, sikur të mos reflektonte pragmatizmin e qetë të mos veprimit. Me të vërtetë, është shumë më e lehtë për vendimmarrësit dhe liderët politikë (dhe për qytetarët e thjeshtë, nga pikëpamja psikologjike) të presin dhe të shohin se çka po ndodh, se sa të luajnë një politikë pro aktive. “Larësit në dorë” pesimist dhe jo aktiv janë zakonisht të prirë të besojnë në moskuptimin dhe parëndësinë e tyre, si dhe në “rrethanat nga lart” të cilat kishin shprehur dhunën. Shumë nga ata, kur mundohen të përforcojnë justifikimin për mos veprimin e tyre, shpeshherë përmendin arsye biologjike dhe antropologjike se për çka luftojnë njerëzit.⁶

⁶ Kur masakrat në Kosovë, Bosnje dhe Ruandë goditën komunitetin ndërkombëtar, dhe u shtrua pyetja mbi intervenimin e mundshëm, u dëgjuan komente si: “këta njerëz kanë luftuar gjithnjë” dhe “ata e kanë në gjak luftën, asgjë nuk mund të bëjmë” kaluan qindra herë nëpër media. Pastaj, kur ndodhi ngjarja tragjike në Kolumbinë më 1999, kur dy studentë masakruan 12 studentë të tjerë dhe profesorin, zëdhënësi i asaj zone thoshte se: “Ju mund të bëni gjithçka që është e mundur për të krijuar një ambient të volitshëm për çdo njeri, por ndonjëherë natyra njerëzore do t’ju ndërpres.” (Ury, William L., *Must We Fight? From the Battlefield to the Schoolyard – A New Perspective on Violent Conflict and Its Prevention*, 2001, Jossey-Bass, San Francisco, pp. 11-13).

Volteri, për shembull, shprehi mendimin e përhapur të asaj kohe duke pohuar që skllavëria është aq e vjetër sa mendimi që lufta është në natyrën e njeriut. Rreth një shekull më parë, Sigmund Freud, pohoi, se besonte që ekzistimi i një instinkti shkatërrues dhe agresiv shtrihet në rrënjët e luftës.⁷ Disa dekada më vonë një shkencëtar tjetër nga e ashtuquajtura “shkolla pesimiste e mendimit” me origjinë luftarake – në librin “*On Aggression*” (1966) Konrad Lorenz, duke ndjekur perspektivën Freudiane, tha që njerëzit kanë një instinkt agresiv i cili mund të shkaktojë rezultate vdekjeprurëse nëse nuk shkarkohen me kohë.

Hetimet dhe studimet e fundit në fushën e primatologjisë, antropologjisë dhe zgjidhjeve të konflikteve, sugjerojnë një pasqyrë mjaft ndryshe të natyrës së njeriut me implikime se si mund të parandalohen luftërat sot.⁸ E ashtuquajtura Deklarata mbi Dhunën, e cila u nënshkrua në vitin 1986, nga disa intelektualë të fushave të ndryshme shkencore, hodhi poshtë pretendimet biologjike të cilat u përdorën për të arsyetuar dhunën dhe luftërat.⁹

Ka edhe më shumë teori të tjera optimiste të tilla si ajo e fundit, por edhe pesimiste, të cilat shpjegojnë se pse njerëzimi është kaq shkatërrimtarë dhe lufton në mesin e të njëjtës specie. Nuk është qëllimi i këtij punimi t’i përmendë të gjitha këto, por është me rëndësi të jesh i vetëdijshëm për arsyet biologjike si dhe antropologjike të agresivitetit. Dhuna dhe luftërat janë të pashmangshme në lidhjet ndërkombëtare bashkëkohore, sqarime mbi rrënjët e dhunës dhe luftës dhe më vonë parandalimi i konfliktit. Nëse kjo tezë vërtetohet, atëherë mund të diskutojmë me sukses mbi parandalimin e konfliktit aq sa të jetë e mundur, pa ri-programim të trurit të njeriut.

⁷ *Ibid.*

⁸ *Ibid.*

⁹ Deklarata e Sevilës mbi dhunën, Spanjë, 1986. http://portal.unesco.org/education/en/ev.php-URL_ID=3247&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html, vizituar me 15 Shkurt 2009.

Definicioni i parandalimit të një konflikti

Proverbi i vjetër, *më mirë është të parandalosh se sa të shërosh*, i cili është i njohur në shumë kultura të botës, përshtatet edhe në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Edhe nëse e mënjanojmë aspektin moral të parandalimit të luftërave dhe evitimin e humbjes së jetëve, kemi një argument të fortë për t'u munduar të parandalojmë konflikte: shpenzimet për të parandaluar gjakderdhje dhe shkatërrime totale janë shumë më të ulëta se sa shpenzimet e hatashme për konflikte të armatosura.¹⁰ Brown dhe Rosecrance, të cilët kanë bërë analiza shkencore mbi parandalimin e konflikteve në disa raste, thonë se parandalimi ka qenë dukshëm me i lirë në të gjitha rastet. Duke e marrë parasysh raportin e parandalimit dhe luftës, arrijmë në këto rezultate: 1:1,3 me 1:479 (mesatarisht 1:59).¹¹ Natyrisht që krejt kjo nuk duhet të varet nga fakti financiar – nëse komuniteti ndërkombëtar (le të jetë ky shteti, organizata ndërkombëtare ose ndonjë subjekt tjetër) dëshiron ta provojë veten si udhëheqës i besuar, atëherë duhet të ketë parasysh edhe faktin që mund të shpjegohet si obligim-përgjegjësi morale për të evituar vuajtje të njerëzimit.

Sigurisht që është e vështirë të vlerësojmë një ose disa veprime të caktuara si të mira (apo të këqija) të mekanizmit për parandalim të konflikteve në nivel ndërkombëtar. Termi *parandalim i konfliktit* dëgjohet kohën e fundit shumë më shpesh se përpara në marrëdhënie ndërkombëtare – menjëherë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, kur një shpërthim i dukshëm i kërkesave për vetëvendosje të plotë etnike ndodhi, u përdor kryesisht termi *zgjidhje e konfliktit*. Lund pohonte se nuk është e qartë nëse aktivitetet e kryera në kuadër të rubrikës së parandalimit të konfliktit janë të reja, pavarësisht nga

¹⁰ Sipas statistikave mbi harxhimet që bëhen për të parandaluar luftëra dhe ato që bëhen në vende kur lufta veç ka filluar atëherë shihet që ato janë shumë më të larta dhe që kanë mundur të bëhen kursime sikur konflikti të ishte parandaluar. (Lund, Michael S., *Methods of Managing Conflict*. In Bercovitch, Jacob (ed.) *The SAGE Handbook of Conflict Resolution*, Sage Publications Ltd., Los Angeles, 2008, pp. 308).

¹¹ Brown, Michael and Rosecrance, David, *The Costs of Conflict: Prevention and Cure in the Global Area*, Rowman and Littlefield, Lanham, 1999.

paqartësia e të rriturit në famë, analistët kanë hartuar një definicion thelbësor.¹²

Definicionet për parandalim të konflikteve kanë ndryshuar në dy aspekte kryesore: a) faza parandaluese kur dhuna është në pyetje, dhe b) metodat parandaluese të cilat përdoren varësisht nga konflikti potencial. Parandalimi i një konflikti vlen për situata paqësore ku dhuna fizike është e mundur, duke u bazuar këtu në tregues tipik të ngritjes së armiqësisë. Polemikë publike të cilat janë aq armiqësore sa që grupet shoqërore ndalojnë së biseduari, janë të dëmshme për shoqërinë, por janë shumë më të parrezikshme, se sa kur shtetet apo grupet tentojnë të vrasin njeri tjetrin me armë vdekjeprurëse.¹³

P. Douma, L. Van de Goor dhe K van Walraven pohojnë se janë dy mënyra kryesore për ta definuar parandalimin e konflikteve. Mënyra e parë është e shkurtër, e shpjegon parandalimin e konflikteve, parasheh çdo lloj aktiviteti (politik, ushtarak apo ekonomik) për të parandaluar një shpërthim të dhunës (sipas këtij definicioni, një parandalim i konfliktit mund të ndërmerret vetëm nëse një konflikt nuk e ka arritur shkallen e dhunës). Mënyra e dytë e cila shpjegohet më gjerësisht, parasheh çdo lloj aktiviteti (politik, ushtarak dhe ekonomik) për të parandaluar ose shpërthimin e dhunës ose shkallëzimin e ndonjë konflikti të dhunshëm (sipas këtij definicioni, parandalimi i një konflikti varet nga konceptet si reduktim, ndalim ose menaxhim, madje edhe ndërhyrje në ndonjë konflikt).¹⁴

Parandalimi i konflikteve duhet të ndahet në dy kategori, në menaxhim dhe në zgjidhje të konfliktit, meqë ai ndodh (ose më mirë të them, duhet të ndodhë) para tyre. Si pasojë, parandalimi

¹² Lund, Michael S., *Methods of Managing Conflict*. In Bercovitch, Jacob (ed.) *The SAGE Handbook of Conflict Resolution*, Sage Publications Ltd., Los Angeles, 2008, pp. 288.

¹³ *Ibid.*

¹⁴ P. Douma, K. van de Goor, K. Van Walraven, *Research Methodologies and Practice: A Comparative Perspective on Methods for Assessing the Outbreak of Conflict and the Implementation in Practice by International Organisations*, in P. Cross and G. Rasamoelina (eds.), *Conflict Prevention Policy of the European Union*, p. 80, in Kronenberger, Vincent and Wouters, Jan, *The European Union and Conflict Prevention: policy and legal aspects*, 2004, TMS Asser Press, Haag, pp. XXIII-XXIV.

i konfliktit duhet të parandalojë konfliktin para se të ndodhë, dhe menaxhimi i konfliktit nevojitet atëherë kur një konflikt veç ka filluar, dhe parasheh ndërhyrje te palët e armiqësuar. Megjithatë, parandalim i konfliktit duhet të kuptohet si koncept i parandalimit *ndërmjet dhe brenda* shteteve përkatëse.¹⁵

Siç e kemi parë, konceptimet e fundit të parandalimit të konflikteve e kanë zgjeruar konceptin gati në të gjitha mjetet e mundshme të shmangies së konfliktit, për të kontribuar në zgjidhjen e tij në mënyrë paqësore. Prandaj, koncepti, i cili zbatohet në marrëdhënie ndërkombëtare, duhet të kuptohet në kohën e sotme gjerësisht, si një grumbull i strategjive, politikave, mekanizmave, mjeteve, iniciativave dhe veprimeve të tjera, të cilat mund t'i zbusin tensionet në mes të dy ose më shumë palëve kundërshtuese, gjë që mund të vije deri te shpërthimi i dhunës nëse nuk arrihet ndonjë marrëveshje e përshtatshme për palët përkatëse.

Zhvillimi i konceptit (bashkëkohor) për parandalimin e konflikteve

Sidoqoftë, parandalimi i konfliktit kurrë nuk është kuptuar si qasje gjithëpërfshirëse. Ai është zhvilluar gjatë shumë shekujve, mirëpo zhvillimet më të rëndësishme janë bërë gjatë gjashtë dekadave të fundit. Nëse e vështrojmë konceptin e parandalimit bashkëkohor të konflikteve nga prizma e zhvillimit historik, atëherë duhet të vërejmë që termi në fjalë ka prejardhjen nga Kombet e Bashkuara (KB), gjegjësisht nga Sekretari i Përgjithshëm Dag Hammarskjold në vitin 1960. Është e vërtetë që termi "*parandalon*" (ose *parandalim*, *parandalues*, *duke mos lejuar*) është përdorur shtatë herë në Statutin e KB-së – dhe për çudi, Konventa e Ligës së Kombeve e ka përmendur termin *parandalon* (ose *parandaluar*, *parandalim*) gjashtë herë,¹⁶ mirëpo, përdorimi i këtij termi në dokument paraqitet gjithmonë si

¹⁵ Kronenberger, Vincent and Wouters, Jan, *The European Union and Conflict Prevention: policy and legal aspects*, 2004, TMS Asser Press, Haag, pp. XXII-XXIII.

¹⁶ Pakti i Lidhjes së Kombeve, 1924.

përcjellës i një konteksti dhe asnjëherë si koncept i tillë.¹⁷ Për këtë arsye është vështirë të thuhet nëse baballarët e Themelimit të KB-së (ose ata të Lidhjes së Kombeve) kanë menduar gjerësisht mbi termin e parandalimit të konflikteve. Sidoqoftë, ia vlen të përmendet që këto dy organizata janë themeluar për të parandaluar luftëra potenciale. “Për të ruajtur brezat e ardhshme nga goditja e luftës”,¹⁸ është mendimi i parë dhe ndoshta më i njohur i Preambulës së KB-së, i cili nuk nënkupton asgjë tjetër përpos parandalimit të pasojave vdekjeprurëse dhe gjakderdhëse.

Siç u cek edhe më herët, Hammarskjöld ishte pionieri i konceptit për parandalim të konflikteve në marrëdhënie ndërkombëtare, koncept ky i cili u zhvillua gjatë disa dekadave.

Kur Hammarskjöld e përdori për herë të parë termin “diplomaci preventive”, ai kishte në mendje ta mbajë KB-në superfuqi në luftërat e shteteve të Botës së Tretë, para se ato të shkallëzohen në tërë botën, argumenton Lund. Kur në fund të Luftës së Ftohtë ndodhën ndryshime të papritura në sigurinë botërore, me luftëra ndër-shtetërore të tilla si në Jugosllavi, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së, Boutros Boutros-Ghali, e zgjeroi termin e Hammarskjöld duke thënë se, nuk duhet të parandalohen vetëm luftërat që marrin përmasa botërore, por të

¹⁷ Neni 1, Paragrafi 1 i Paktit të Kombeve thotë se ndër synimet e KB-së janë edhe “[...] masat efektive kolektive për parandalimin dhe mënjanimin e kërcënimeve ndaj paqes» që do të ndërmerren për të ruajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. (Pakti i Kombeve të Bashkuara, Neni 1). Përdorimi i dytë i termit në Nenin 2, Paragrafi 5, thotë se anëtarët e KB-së: “[...] do të përmbahen nga dhënia e ndihmës për ndonjë shtet kundër të cilit Kombet e Bashkuara janë duke marrë masa parandaluese ose përforcuese”. Termi në Nenin 5 ka të njëjtën domethënie si në Nenin 2, dhe thotë se »një anëtar i Kombeve të Bashkuara kundër të cilit janë marrë masa parandaluese të zbatimit të veprimit nga Këshilli i Sigurimit mund të jetë i pezulluar nga ushtrimi i të drejtave dhe privilegjeve të anëtarësisë». Përdorimi në vijim i këtij termi gjendet në Kapitullin e famshëm VII. Neni 40 thotë: “me qëllim për të parandaluar një përkeqësim të situatës ...” Neni 50 e përdor termin në të njëjtën mënyrë si Neni 2 dhe 5: “Në rast të zbatimit të masave parandaluese kundër ndonjë shteti, janë marrë [...]” Ndërsa, Neni 53, Paragrafi 1, sjell diçka të re në lidhje me përdorimin e termit: “[...] Organizata mundet, me kërkesën e qeverive të shqetësuara, të ngarkohet me përgjegjësinë për parandalimin e mëtejshëm të një agresioni nga një shtet tjetër”. Përdorimi i fundit i termit gjendet në nenin 95, por që nuk është e rëndësishme ta përdorni atë për diskutimin tonë, për shkak se termi përdoret në një kuptim tjetër: “Asgjë në këtë Pakt nuk do t’i parandalojë anëtarët e Kombeve të Bashkuara nga zgjidhja e mosmarrëveshjeve të tyre në gjykata të tjera [...]” (Pakti i Kombeve të Bashkuara, Neni 1, 2, 5, 40, 50, 53, 95).

¹⁸ The Charter of the United Nations, Preamble, 1945.

gjitha format e dhunës gjakderdhëse.¹⁹ Agjenda për Paqe (1992) e Boutros-Ghali përmban një kontribut të rëndësishëm për konceptin e parandalimit të konflikteve, me diplomaci preventive (duke u përpjekur për të gjetur zgjidhje të problemeve para se dhuna të shpërthejë) si një shtyllë bazë për t'iu përgjigjur konflikteve pas Luftës së Ftohtë. Në kapitullin III të Agjendës për Paqe, Boutros-Ghali i ceki këto masa si mjete të diplomacisë preventive: ngritje të besimit, grumbullim i fakteve, paralajmërim i hershëm, shpërndarje preventive dhe zona të çmilitarizuara.²⁰

Sekretari i Përgjithshëm vijues i KB-së, Kofi Annan, ka bërë më shumë për të avancuar idenë dhe praktikën e parandalimit të konflikteve të dhunshme. Ndër nismat më të rëndësishme që ai ka përhapur ishte ndryshimi i pikëpamjes së KB-së nga “një kulturë të reagimit në një kulturë të parandalimit” duke qartësuar disa argumente kryesore për reagim preventiv. Ndër të tjerë, edhe Annan ka apeluar për përgjegjësi morale të KB-së, për të ndaluar dhunën e shkallës së lartë siç është gjenocidi.²¹

Rëndësia e masave preventive u aprovua edhe si ligj nga agjencitë e KB-së (p.sh. Banka Botërore, Shërbimi Botëror i Mjedisit), organizatat rajonale (p.sh. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Bashkimi Evropian (BE)), agjencitë ndër rajonale (p.sh. Komuniteti për Zhvillim i Afrikës Jugore, Komuniteti i Ekonomisë i disa shteteve nga Afrika Perëndimore), agjencitë për zhvillim të disa shteteve të mëdha si dhe nga disa aktorë joqeveritarë.²²

¹⁹ Lund, Michael S., *Methods of Managing Conflict*. In Bercovitch, Jacob (ed.) *The SAGE Handbook of Conflict Resolution*, Sage Publications Ltd., Los Angeles, 2008, f. 288.

²⁰ Boutros-Ghali, Boutros, *The Agenda for Peace: Preventive Diplomacy, Peacemaking and Peacekeeping*, 1992, United Nations, New York.

The Agenda for Peace: Preventive diplomacy, peacemaking and peace-keeping, report of the Secretary-General, 1992. <http://www.un.org/docs/SG/agpeace.html>, vizituar më 15 Shkurt 2009.

²¹ Ackermann, Alice, *The Idea and Practice of Conflict Prevention*, *Journal of Peace Research*, Vol. 40, Nr. 3, 2003, pp. 340.

²² *Ibid.*

Bashkimi Evropian dhe parandalimi i konflikteve

Në vitet pas përfundimit të Luftës së Ftohtë është përmendur gjithnjë e më shumë parandalimi i konflikteve, megjithatë as KB-ja por as organizatat (për siguri) rajonale nuk kanë bërë ndonjë hap së bashku për të parandaluar konflikte. Në të vërtetë, aty qëndron një mosmarrëveshje e përgjithshme mbi nivelin e duhur për të arritur një gjë të tillë.²³ Vitet e “suksesshme” prej themelimit të Bashkësisë Evropiane për Thëngjill dhe Çelik më 1951, dhe pastaj themelimi i Bashkimit Evropian për Ekonomi më 1957, dhe më 1992 themelimi i BE-së, çuan tek ideja se organizatat mund të ndihmojnë në parandalimin e zhvillimit të konflikteve vdekjeprurëse brenda dhe jashtë territorit të saj tradicional “operativ”. BE-ja, duke qenë njëri ndër garantuesit kryesor për stabilitet në Ballkanin Perëndimor, dhe i njohur si i tillë nga shtetet përkatëse, ka zhvilluar dhe zgjeruar dukshëm konceptin për parandalim të konflikteve gjatë viteve të fundit.²⁴

Nëse shtetet e Ballkanit Perëndimor, pa përjashtuar Kosovën, duan ta tregojnë vetën si partnerë të besueshëm dhe të ngushtë të BE-së, ata duhet t’i nënshtrohen një mbikëqyrjeje të saktë dhe të gjatë deri sa do të jenë të gatshëm t’i qasen klubit evropian. Prandaj, elita politike e Kosovës duhet që të vendosë shumë lart në agjendën e vet të prioritetëve nevojën për t’i përshtatur politikat e veta në atë fushë, apo thënë më mirë të përvetësojë kuptimin bashkëkohor të parandalimit të konflikteve. Sidoqoftë kjo nuk do të jetë e mjaftueshme, si

²³ Duke, Simon, Regional organizations and conflict prevention: CFSP and ESDI in Europe, in Carment, David and Schnabel, Albert, *Conflict Prevention: Path to Peace or Grand Illusion?*, 2003, Tokyo, The United Nations University Press, pp. 92.

²⁴ Në Këshillin Evropian në Göteborg, në qershor 2001, ku morën pjesë kryetarët e 15 shteteve dhe qeverive të BE-së, u tha se "parandalimi i konflikteve është një nga objektivat kryesore të Bashkimit për Marrëdhënie me Jashtë dhe duhet të integrohet në të gjitha aspektet relevante [...]” Si pasojë, rezultatet e analizave të shumta mbi këtë çështje janë botuar kohët e fundit për të diskutuar vështirësitë, sfidat dhe kapacitetet e BE-së si një aktor efektiv të parandalimit të konflikteve, si për shembull nga Kronenberger, Vincent and Wouters, Jan, *The European Union and Conflict Prevention: policy and legal aspects*, 2004, TMS Asser Press, Haag; Duke, Simon, Regional organizations and conflict prevention: CFSP and ESDI in Europe, in Carment, David and Schnabel, Albert, *Conflict Prevention: Path to Peace or Grand Illusion?*, 2003, Tokyo, The United Nations University Press, pp. 91-111.

pasojë do të jetë e domosdoshme që të veprohet në pajtueshmëri më atë.

Ndonëse nuk është e definuar në mënyrë specifike, BE-ja e konsideron veten si organizatë e cila synon parandalimin e (suksesshëm) konflikteve, për më tepër, BE-ja pretendon së është thellë e angazhuar në parandalimin e konflikteve, dhe njëkohësisht pranon se mund dhe duhet të bëjë më tepër. BE-ja pohon se ka mjete të ndryshme financiare dhe politike për të mbështetur përpjekjet për parandalimin e konflikteve, siç janë:²⁵

- a) Bashkëpunimi për zhvillim dhe ndihma e jashtme,
- b) Instrumentet për politika tregtare,
- c) Ndihma humanitare,
- d) Politikat sociale dhe të ambientit,
- e) Instrumentet diplomatike dhe dialogu politik,
- f) Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat joqeveritare
- g) Si dhe instrumentet e reja në fushën e menaxhimit të krizave.

Zakonisht thuhet se Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (CFSP) dhe Identiteti Evropian për Siguri dhe Mbrojtje (ESDI) kanë rol në parandalimin e konfliktit.

Sidoqoftë, avancimi nga faza konceptuale në atë praktike për parandalimin e konflikteve, pjesërisht varet nga vullneti i shteteve anëtare të BE-së dhe NATO-s, për t'u dhënë substancë koncepteve përkatëse, si dhe mbështetet në mirëkuptimin e dukshëm në nivel politik për t'i dhënë prioritet parandalimit të konflikteve.

Sidoqoftë, përvoja e ESDI-së dhe CFSP-së në parandalimin e konflikteve është tepër e limituar. Deri në intervenimin e NATO-së më 1999, për shkak të krimeve të kryera në Kosovë, për shumë njerëz nuk ishte i dukshëm roli i CFSP-së ose ESDI-së në parandalimin e konflikteve. Dokumentet zyrtare dhe

²⁵ [Directorate-General for External Relations](http://ec.europa.eu/external_relations/cfsp/cpcm/index.htm) of the EU, *Conflict Prevention & Civilian Crisis Management - Overview* http://ec.europa.eu/external_relations/cfsp/cpcm/index.htm. Vizituar me 13 Shkurt 2009).

literaturat akademike mbi sigurinë në Evropë përmenden shumë rrallë parandalimin e konflikteve në këtë kontekst.²⁶

Po ashtu është evidente nga Konsensusi Evropian për Zhvillim, një deklaram i politikave që “reflekton vullnetin e BE-së që do të zhdukë varfërinë dhe që të ndërtojë një botë më stabile dhe më të barabartë”, dhe që BE-ja do të zhvillojë plane gjithëpërfshirëse për shtetet në të cilat ka rrezik për shpërthimin e konflikteve. Politikat e miratuara, nëse aplikohen në mënyrë të duhur, mund të zvogëlojnë rrezikun nga konflikti dhe mund të ndihmojnë në parandalimin e konflikteve duke adresuar shkaqet thelbësore të konflikteve të dhunshme, duke e përfshirë varfërinë, degradimin, shfrytëzimin, distribuimin e pabarabartë, qasjen në toka dhe resurse natyrore, qeverisje të dobët, shkelje të të drejtave njerëzore dhe pabarazi gjinore. Për më tepër, BE-ja do të promovojë dialogun, pjesëmarrjen dhe pajtimin me qëllim të promovimit të paqes dhe parandalimit të shpërthimit të dhunës.²⁷

Ndër iniciativa të tjera, është me rëndësi të përmendet edhe Strategjia Evropiane për Siguri (2003), e cila thërret për një qasje të integruar për parandalimin e konflikteve dhe menaxhimin e krizave, si dhe për rreziqe të tjera që cenojnë sigurinë.²⁸ Politika evropiane e fqinjësisë, një kornizë që ka për qëllim parandalimin e konflikteve në shtetet fqinjë të BE-së, së bashku me instrumentet e ndryshme të politikave dhe aktiviteteve për parandalimin e konflikteve, duhet të përmenden po ashtu.²⁹

Pra, ku qëndron Kosova në tërë këtë rrëfim? BE-ja, në këtë rast Komisioni Evropian dhe shumica e shteteve anëtare janë të

²⁶ Duke, Simon, Regional organizations and conflict prevention: CFSP and ESDI in Europe, in Carment, David and Schnabel, Albert, *Conflict Prevention: Path to Peace or Grand Illusion?*, 2003, Tokyo, The United Nations University Press, pp. 94.

²⁷ *The European Consensus on Development*, Joint Statement by the Council and the Representatives of the governments of the Member states meeting with the Council, the European Parliament and the Commission, 2005, pp. 26, http://ec.europa.eu/development/icenter/repository/eu_consensus_en.pdf, vizituar me 20 Shkurt 2009.

²⁸ *A Secure Europe in a Better World: European Security Strategy*, adopted by the European Council, 12th December 2003, <http://www.consilium.eu.int/uedocs/cmsUpload/78367.pdf> (20th February 2009).

²⁹ European Commission, *The Policy: What is the European Neighbourhood Policy?*, 2008, http://ec.europa.eu/world/enp/policy_en.htm, accessed 20th February 2009.

përkushtuara në stabilizimin e Kosovës, që nënkupton angazhim të madh në parandalimin e konflikteve.³⁰ Nuk është shumë pretenduese të thuhet që strategjia e BE-së për parandalimin e konflikteve në Kosovë, së paku në nivelin deklarativ, përfshinë të gjitha elementet e rëndësishme të një qasjeje gjithëpërfshirëse në parandalimin e konflikteve. Një qasje e tillë e përdorur jo vetëm nga BE-ja, por edhe nga shumica e organizatave ndërkombëtare (KB, OSBE etj.), definohet me termin parandalim strukturor.

Domosdoshmëria e parandalimit strukturor (përballë parandalimit operativ)

Mund të jetë në natyrën e qenieve njerëzore që kryesisht të veprojnë në mënyrë retroaktive, që të ndërmarrim masa vetëm atëherë kur diçka e padëshirueshme ndodh. Mjetet tradicionale për parandalimin e konflikteve, që kanë për qëllim të parandalojnë zgjerimin e konfliktit në çastin kur konflikti ka filluar të eskalojë, që kërcënon të marrë drejtim të dhunshëm, apo tashmë ka marrë drejtim të dhunshëm, janë drejtpërsëdrejti të fokusuara për t'u bindur palët potencialisht të dhunshme, që të ndryshojnë sjelljet e tyre. Këto mjete mund të quhen si parandalim operativ. Shembuj të parandalimit të konflikteve me mjete tradicionale të cilat në një afat të shkurtër mund të japin rezultate por nuk adresojnë shkaqet thelbësore të dhunës janë: presioni diplomatik, ndërmjetësimi, negociatat paqësore, mbështetja financiare, ekonomike, ushtarake, kërcënimet

³⁰ BE-ja ka përsëritur (më së fundmi në qershor 2008 në Këshillin Evropian) "që Kosova ndër Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ka një perspektivë të qartë evropiane në përputhje me perspektivën evropiane të rajonit të Ballkanit Perëndimor." BE-ja mbetet e angazhuar për të luajtur një rol udhëheqës në sigurimin e stabilitetit të Kosovës nëpërmjet misionit të sundimit të ligjit evropian për Siguri dhe Mbrojtje përmes përfaqësuesit të posaçëm të saj dhe gjithashtu kontributit të saj për Zyrën Civile Ndërkombëtare. Për më tepër, të hollat e premtuara nga donatorët e BE-së (Komisionit dhe Shteteve Anëtare të BE-së) në Kosovë në konferencën e donatorëve në Bruksel kanë tejkaluar 1,2 miliard euro. Më shumë mbi Komisionin Evropian, Kosovë - BE marrëdhëniet kosovare, 2008. http://ec.europa.eu/enlargement/potential-candidatecountries/kosovo/eu_kosovo_relations_en.htm, vizituar me 23 Shkurt 2009.

diplomatiqe, sanksionet ekonomike, embargo në armatim, dërgimi i personelit civil apo ushtarak si monitorues të paqes apo paqeruajtësit.³¹

Ballkani Perëndimor, si edhe Kosova, kanë qenë dëshmitarë apo ende janë subjekt i shumicës së mjeteve tradicionale të parandalimit të konflikteve. Nëse mjete të forta ndëshkuese janë përdorur nga komuniteti ndërkombëtar për të bërë ndryshime në dekadën e parë pas shpërbërjes së Jugosllavisë (posaçërisht ndaj regjimit të Milosheviqit në Republikën Federale të Jugosllavisë), mjete shumë më premtuese dhe proaktive, që do t'i quanim “karota”, janë përdorur pas vitit 2001 për Serbinë, Malin e Zi dhe Kosovën.

Sidoqoftë, mjetet tradicionale parandaluese janë të nevojshme për të ndalur dhunën, por nuk mund të jenë bazë e qëndrueshme për zgjidhjen e konfliktit. Nëse ia dalin të parandalojnë gjakderdhjen, atëherë do të ketë kohë për një parandalim proaktiv sistematik gjithëpërfshirës dhe afatgjatë të konfliktit. Ky është momenti kur në shumicën e shteteve në të cilat aplikohet një qasje e tillë, dështojnë. Kjo fazë e gjatë, zakonisht e shtrenjtë dhe shpesh jo e popullarizuar e konfliktit, e cila sipas definicioneve koïncidon me rindërtimin dhe zgjidhjen e konfliktit, është faza e cila do të siguronte bazë të qëndrueshme për rindërtimin e shoqërisë. Zakonisht është e vështirë që të mobilizohen burimet e mjaftueshme për një qasje proaktive në parandalimin e konflikteve, kur konflikti është i “fshehur” apo në të ashtuquajturën fazën latente në agjendat politike, përparësi kanë çështje të tjera. Këndvështrimi i elitës (si edhe i opinionit) është logjik: pse duhet që vendi të harxhojë kohë, energji dhe resurse për diçka që nuk sjell rezultate të menjëhershme?

Megjithatë, nuk mjafton që të kemi një listë të gjatë të mjeteve strukturore parandaluese, pa një strategji koherente parandaluese. Secili model i strategjisë parandaluese duhet të jetë specifik nga rasti në rast, që do të thotë se, është e pamundur të zbulohet një formulë e cila mund të zbatohet në

³¹ Keukeleire, Stephen, EU Structural Foreign Policy and Structural Conflict Prevention, in Kronenberger, Vincent and Wouters, Jan, *The European Union and Conflict Prevention: policy and legal aspects*, 2004, TMS Asser Press, Haag, pp. 151.

çdo rast. Për të operacionalizuar një strategji të tillë parandaluese kërkohet koordinim i veprimeve nga aktorët parandalues, si dhe monitorimi dhe vlerësimi i efekteve të aksioneve të ndërmarra parandaluese. Lundi rekomandon udhëzime për formulimin e politikave efektive parandaluese, të cilat mund të ndahen në tri pjesë: **analiza e konfliktit**: (diagnostifikimi i shkaqeve strukturore dhe imediate të parandalimit të konfliktit, dhe identifikimi i aktorëve potencial parandalues), **analiza parandaluese**: zgjedhja e masave parandaluese në përputhje me shkaqet e diagnostifikuara të konfliktit si dhe vlerësimi preliminar i efekteve të mundshme të masave të ndërmarra) dhe **aksioni parandalues**: si të organizohet (dhe implementohet aksioni parandalues, monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të aksioneve të ndërmarra).³²

Konkluzione

Qëllimi kryesor i këtij punimi nuk është diskutimi mbi atë se cila do të ishte alternativa më e mirë për t'iu qasur detyrës së vështirë dhe komplekse të parandalimit të konfliktit në Kosovë, por për të qartësuar dhe për të tërhequr vërejtjen për kurthet në të cilat mund të hasin vendimmarrësit. Do të ishte pretencioze që të këshillojë elitat politike në Kosovë se cilën strategji për parandalim të konfliktit të përdorin. Iu takon atyre që të zgjedhin dhe vendosin për qasjen, bazuar në specifikat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të realiteteve të reja politike në Ballkanin Perëndimor. Do të jetë meritë e tyre që të vjelin frutat e tranzicionit të suksesshëm dhe bashkëjetesës paqësore të popujve të tyre, sikur që duhet të ishte përgjegjësi për mossauesin e mundshëm. Në fakt është e vërtetë se ajo që kanë trashëguar (de jure një vit më parë me shpalljen e pavarësisë, dhe de facto që nga viti 1999, kur ishte vendosur protektorati i bashkësisë ndërkombëtare) nuk është për t'iu pasur zili. Korrupsioni, krimi i organizuar, papunësia dhe

³² Ackermann, Alice, *The Idea and Practice of Conflict Prevention*, Journal of Peace Research, Vol. 40, Nr. 3, 2003, pp. 343-344.

problemet e tjera të lidhura me ekonominë në tranzicion, janë vështirësi të mëdha për Kosovën dhe popullin e saj, por nuk duhet të shërbejnë si arsye për mosveprim.

Do të ishte pretencioze, po ashtu, të themi se bashkësia ndërkombëtare si tërësi e mbështet tranzicionin e Kosovës në një shtet bashkëkohor. Mirëpo, është premtuese se një pjesë e rëndësishme e bashkësisë ndërkombëtare e mbështetin këtë shtet të ri: duke pasur pas vete shumicën dërmuese të BE-së, SHBA-në, dhe disa lojtarë të rëndësishëm të tjerë, është një pikënisje e mirë për Kosovën. BE-ja (EULEX), ndonëse me status ligjor dhe moral të vënë në pyetje në disa pjesë të Kosovës, ka arritur të zhvillojë qasje strukturore në parandalimin e konfliktit, por i mbetet Kosovës të vendosë se a do t'i shfrytëzojë ato apo jo. Parandalimi operativ i konflikteve deri tash ka arritur të parandalojë episode të reja të gjakderdhjes në Ballkanin Perëndimor, por suksesi i parandalimit strukturor të konfliktit do të jetë çelës i dështimit apo suksesit të Kosovës.

Përktheu nga anglishtja Dafina Vezaj

Bibliografia

Ackermann, Alice, *The Idea and Practice of Conflict Prevention*, Journal of Peace Research, Vol. 40, Nr. 3, pp. 339-347, 2003.

Bercovitch, Jacob (ed.) *The SAGE Handbook of Conflict Resolution*, Sage Publications Ltd., Los Angeles, 2008.

Brown, Michael and Rosecrance, David, *The Costs of Conflict: Prevention and Cure in the Global Area*, Rowman and Littlefield, Lanham, 1999.

Boutros-Ghali, Boutros, *The Agenda for Peace: Preventive Diplomacy, Peacemaking and Peacekeeping*, report of the Secretary-General, adopted by the Summit Meeting of the Security Council, 31st January 1992, A/47/277-S/24111, United Nations, New York, 1992.

Carment, David and Schnabel, Albert, *Conflict Prevention: Path to Peace or Grand Illusion?* Tokyo, The United Nations University Press, 2003.

Duke, Simon, Regional organizations and conflict prevention: CFSP and ESDI in Europe, in Carment, David and Schnabel, Albert,

- Conflict Prevention: Path to Peace or Grand Illusion?* Tokyo, The United Nations University Press, 2003.
- Kronenberger, Vincent and Wouters, Jan, *The European Union and Conflict Prevention: policy and legal aspects*, TMS Asser Press, Haag, 2004.
- Lund, Michael S., *Methods of Managing Conflict*. In Bercovitch, Jacob (ed.) *The SAGE Handbook of Conflict Resolution*, Sage Publications, Los Angeles, 2008.
- Mason, David T., Meernik, James D., *Conflict Prevention and Peacebuilding in Post-War Societies. Sustaining the peace*, Routledge, London and Neë York, 2006.
- Office of the Prime Minister of the Republic of Kosovo, *Prime Minister Thaçi: A secure Kosovo means prosperity for the people of Kosovo and stability for the region*, 2009. <http://www.ks-gov.net/pm/Fillimi/tabid/36/EntryID/1672/Default.aspx>, vizituar me 14 Shkurt 2009.
- Peck, Connie, *The United Nations as a Dispute Settlement System: Improving Mechanisms for the Prevention and Resolution of Conflict*. Kluwer Law International, Haag, London and Boston, 1996.
- Ramcharan, B. G., *Conflict Prevention in Practice: Essays in Honour of Jim Sutterlin*, Martinus Nijhoff Publishers, Leiden and Boston, 2005.
- University of Wisconsin, Office of Human Resource Development, *About Conflict*. <http://www.ohrd.wisc.edu/onlinetraining/resolution/aboutehatit.htm#whatisconflict>, vizituar 14 Shkurt 2009.